



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

19.07.2013

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Përfaqësuesit e AKP-së vizituan Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Prishtinë - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, nën udhëheqjen e zv.kryesuesit Skender Komoni, së bashku me menaxhmentin e Agjencisë, nën udhëheqjen e drejtorit menaxhues, z.Shkelzen Lluka, zhvilluan një vizitë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ku u pritën nga kryetari i kësaj Gjykate z.Sahit Sylejmani me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimit me përfaqësuesit e DhPGJS u shqyrtuan mundësit për rritjen e efikasitetit të punës së këtyre dy institucioneve duke marrë parasysh se procesi i administrimit dhe privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është ngusht i lidhur në mes AKP-së dhe DhPGJS-së. Çështjet si listat e punëtorëve përse i përket 20 %, procesi i likuidimit, procesi i riorganizimit dhe rivitalizimit të ndërmarrjes Trepça, ishin ndër temat kryesore në këtij takimi, ku të dy palët u dakorduan që të bashkërendojnë veprimet me qëllim të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të DhPGJS, në mënyrë që të mundësohet efikasitet më i madh në trajtimin e çështjeve që lidhen me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe përmbylljen e këtij procesi me rëndësi për ekonominë e vendit.

DhPGJS-ja shqyrton kërkesat apo ankesat që dalin apo kanë lidhje me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, kërkesat apo ankesat në lidhje me të drejtat legjitime të punëtorëve, kërkesat e përgjithshme pronësore apo kreditore në lidhje me një ndërmarrje apo korporatë, ankesat apo çështjet tjera që dalin apo kanë lidhje me likuidimin e një ndërmarrje shoqërore apo pasurie të saj, të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me riorganizimin apo ristrukturimin e një ndërmarrje shoqërore etj., ndërsa vendimet e DhPGJS janë obliguese për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

FUND

Rr. Ilir Konushevcu No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org